



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për financa
Sekretarijat za finansije

Nr./Br. 05-411/24- *891/1*

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 152

finansije@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 09.02.2024. godine

Lënda: Lajmërim publik

Informohen të gjithë pronarët e pasurive të patundshme në territorin e Komunës së Tuzit, se Sekretariati për financa i Komunës së Tuzit, bazuar në nenin 87 të Ligjit për procedurën administrative ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi" nr. 056/14, 020 / 15, 040/16 dhe 037/17), e në lidhje me nenin 6 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së qeverisjes lokale të Komunës së Tuzit ("fletorja Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale" nr. 022/23 i 024/23), **do të bëjë dorëzimin e aktvendimeve përmes lajmërimit publik**, për të gjitha aktvendimet e pa dorëzuara mbi tatimin e caktuar në patundshmëri për vitin 2023, me datën 09.02.2024.

Meqenëse nuk ishte e mundur të paraqitej akti në fjalë në një nga mënyrat e përshkruara në nenet 84 dhe 85 të Ligjit për Procedurën Administrative, ky Sekretariat e dorëzon aktin përmes njoftimit publik, d.m.th., duke e publikuar në tabelën e njoftimeve të Komunës, në faqen e internetit të Komunës së Tuzit (www.tuzi.org.me), në faqen FB dhe Instagram të Komunës së Tuzit dhe në TV Boin, si dhe në portalin euprava.me.

Dorëzimi përmes njoftimit publik konsiderohet i përfunduar pas skadimit të 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të letrës. Data e publikimit është 09.02.2024. kështu që data e skadimit të afatit është 20.02.2024.

Vështrimi i arsytimit dhe aktvendimeve mund të bëhet personalisht në ambientet zyrtare të Sekretariatit për Financa të Komunës së Tuzit, ndërtesa e komunës, kati përdhes, zyra numër 11, ose në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së internetit www.laris.me.

SEKRETARIATI PËR FINANCA

